



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT**

**PROGRAMET E KULTURËS SË PËRGJITHSHME TË ARSIMIT  
PROFESIONAL – TEKNIK (APT)**

**PROGRAMI I LËNDËS  
HISTORIA E ARTEVE  
Klasa e 13-të**

**STRUKTURA e APT:** 2+1+1 vite, 2 + 2 vite, bllok 4-vjeçare, lëndë me zgjedhje të detyruar

**DREJTIMI I APT:** Të gjitha drejtimet e arsimit profesional - teknik

**Koordinatori:** MAJLINDA HALA

**Redaktori:**

**Përgjegjës sektori:** MARITA HAMZA

**TIRANË, NËNTOR 2010**

*Historia e arteve* është lënda që do të studiohet në klasën e 13<sup>të</sup> të kulturës së përgjithshme të Arsimit Profesional – Teknik (Struktura: 2 +1 +1 = 4 vite, lëndë me zgjedhje të detyruar; 2 + 2 = 4 vite; dhe bllok në 4 vite). Drejtimet në të cilat do të zhvillohet kjo lëndë janë: si lëndë me zgjedhje e detyruar në drejtimet “*Mekanik, Elektroteknik, Elektronikë, Hoteleri-Turizëm, Teknologji Ushqimore, Përpunim Druri, Bujqësi, Peshkim, Termohidraulikë, Ndërtim*”, struktura: 2 +1 +1 = 4 vite; si lëndë në drejtimin “*Teknologji informimi dhe komunikimi*”, struktura: 2 + 2 = 4 vite; si lëndë në drejtimin “*Ekonomi/Biznes* ” dhe “*Pyje*”, struktura: 2 + 2 = 4 vite; si lëndë në drejtimin “*Veterinari*” që zhvillohet bllok.

Kjo lëndë do të luajë një rol të rëndësishëm në plotësimin e formimit kulturor dhe edukimit të nxënësve, duke zgjeruar më tej njohuritë e tyre për zhvillimin e artit shqiptar dhe atij botëror. Programi jep njohuri të përgjithshme për zhvillimin e historisë së arteve përkatësisht *art pamor, kërcim, muzikë dhe teatër* nga lashtësia deri në ditët tona, arte të cilat ndikuan tek njëri-tjetra dhe ndihmuan në zhvillimin e mëtejshëm të tyre.

Gjithashtu, përmes studimit të përmbajtjeve që ofron ky program, nxënësit do të mësojnë tashmë të diskutojnë rreth *karakteristikave kryesore të veprave të artit*. Lënda e historisë së arteve iu referohet në mënyrë kronologjike zhvillimit në përgjithësi të arteve, si dhe njohjes së vlerave historike dhe artistike. Njohja dhe studimi i historisë së arteve si asaj shqiptare dhe asaj botërore, pasuron kulturën dhe përvojën personale të nxënësve, duke i bërë ata të jenë të ndjeshëm ndaj arteve si dhe duke i bërë që ata të respektojnë më shumë kulturën e vendit të tyre dhe atë botërore. Përmes shtjellimit historik të artit shqiptar në Shqipëri e më gjerë, prezantohen vlerat e veprave artistike shqiptare në të gjitha fushat e sipër përmendura duke kontribuar në *zhvillimin e identitetit kombëtar* të nxënësve.

Njohuritë zhvillohen në rrafshin historik dhe artistik, duke iu referuar zhvillimeve dhe informacionit aktual mbi periudha dhe autorë të ndryshëm të artit shqiptar dhe atij botëror.

## **1. SYNIMI I LËNDËS**

Ky program synon të plotësojë formimin kulturor të nxënësve nëpërmjet njohjes së vlerave të artit shqiptar dhe atij botëror; të sigurojë kulturën e domosdoshme për të kuptuar artet, interpretuar e vlerësuar kulturën dhe veprat e artit kombëtar dhe atij botëror përmes njohjes së *zhvillimit historik dhe kulturor* të veprave dhe autorëve më të spikatur të këtyre fushave artistike.

## 2. OBJEKTIVA TË PËRGJITHSHËM

Në përfundim të këtij programi nxënës/i, - ja:

- të përshkruajë zhvillimin e arteve (art pamor, muzikë, kërcim, teatër) në Shqipëri, Evropë dhe botë, në periudha dhe kontekste të ndryshme, bazuar në vlerat artistike të secilit lloj arti;
- të zhvillojë vetëdijen kombëtare nëpërmjet trajtimit historik të vlerave artistike kombëtare;
- të identifikojë përmes veprave më përfaqësuese të arteve, shqiptarë apo të huaj *autorin, vendin dhe periudhën*, duke përcaktuar *gjininë dhe përmbajtjen e veprës*;
- të analizojë karakteristikat e veprave artistike brenda të njëjtit lloj arti p.sh.: dy piktura të të njëjtës periudhë nga autorë të ndryshëm, etj.;
- të bëjë vlerësimin e një veprë arti më përfaqësuese shqiptare apo ato botërore, përmes konceptit të së bukurës;
- të mbajë një qëndrim personal ndaj një veprë arti shqiptare apo botërore, duke e sjellë atë përmes një analize të thjeshtë apo një eseje.

## 3. OBJEKTIVAT SIPAS LINJAVE

33 javë x 2 orë = 66 orë

### Linja 1: Historia e artit pamor

**Përshkrimi i linjës:** Historia e artit pamor luan një rol të rëndësishëm në edukimin e nxënësve. Nëpërmjet studimit, ata identifikojnë *vlera estetike dhe njerëzore* të artit dhe kuptojnë *ndikimin e tij në shoqëri*. Nxënësit analizojnë përmes një gjuhe të thjeshtë artistike, vepra të ndryshme të artit pamor, shpjegojnë karakteristikat e periudhave dhe veprave të autorëve të ndryshëm që bënë epokë. Nëpërmjet veprës së artit nxënësit mund të njohin të shkuarën dhe aktivitetin njerëzor në periudha të caktuara duke kuptuar se si artisti u jep formë dyshimeve, qartësive ose vlerave që pasqyrojnë karakterin e kohës së tyre. Gjithashtu nxënësit njihen me zhvillimin e artit figurativ në Shqipëri në periudha të ndryshme, me karakteristikat historike, shoqërore dhe kulturore të krijimit të veprave. Për herë të parë vjen njohja konkrete, përmes vlerave reale të artit

figurativ kombëtar dhe përfaqësuesve të tij në periudha të ndryshme.

**Orët e sugjeruara: 19**

Linja	Objektivat
<p><b>Historia e artit pamor</b></p>	<p>Në përfundim të këtij programi nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• të përshkruajë zhvillimet në artin pamor shqiptar dhe atë botëror gjatë periudhave të ndryshme historike, duke u përqendruar në veprat dhe autorët më të spikatur*.</li> </ul> <p>Periudhat e marra në studim:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>○ Arti <i>antik</i>: prehistorik, Arti egjiptian, arti Grek, arti Romak, Kristianizmi i hershëm, Arti Bizantin.</li> <li>○ Arti islamik, Arti afrikan, Arti kinez.</li> <li>○ Arti në <i>mesjetë</i>: Mesjeta e hershme, Romanik, Gotik.</li> <li>○ Arti në <i>Rilindje</i>: Rilindja e parë, Rilindja e lartë, Baroku, Rokoko.</li> <li>○ Arti <i>modern</i>: Neoklasiçizmi, Romantiçizmi, Realizmi, Impresionizmi, Postimpresionizmi.</li> <li>○ Arti në <i>Shqipëri</i> dhe ndikimi nga kultura të tjera: <ul style="list-style-type: none"> <li>- kultura ilire, (Butrinti, Apolonia, Dyrrahu),</li> <li>- mozaikët e lashtë në Shqipëri,</li> <li>- ikonografët e shek. XVIII, Onufri,</li> <li>- periudha e Pavarësisë, arti në vitet njëzet të shek. XX, arti bashkëkohor, Realizmi socialist.</li> </ul> </li> </ul> <ul style="list-style-type: none"> <li>• të mbajë qëndrim personal gjatë analizës që i bën zhvillimit historik të veprave të artit pamor (p.sh. në një</li> </ul>

\* Autorët dhe veprat duhet të jenë më të spikaturit e periudhës.

	<p>debat, ese, projekt etj.), sipas disa kriterëve:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- periudhës dhe autorit,</li> <li>- ndikimeve,</li> <li>- mjedisit social e shoqëror,</li> <li>- mesazhit që përcjell.</li> </ul> <ul style="list-style-type: none"> <li>• të ideojë vetë ose në grup, një projekt që ka të bëjë me zhvillimin historik të këtij arti si p.sh.: evoluimi i artit shqiptar nga shek. XVIII deri në ditët tona, vepra dhe përfaqësues;</li> <li>• të diskutojë mbi ndikimin e artit te vetja dhe në shoqëri, pa paragjykuar mendimet e të tjerëve, p.sh.: parapëlqimet e një arti të një periudhe të caktuar (arti i Rilindjes etj).;</li> <li>• të marrë pjesë si pjesëmarrës ose organizator në, veprimtari të ndryshme artistike në klasë, shkollë, mjedisin ku jeton, në komunitet dhe shoqëri.</li> </ul>
--	---

## Linja 2: Historia e muzikës

**Përshkrimi i linjës:** Historia e muzikës njihet nxënësit me zhvillimin e muzikës shqiptare dhe asaj botërore në periudha të ndryshme historike kohore, si dhe shpjegon karakteristikat dhe ndikimet e muzikës shqiptare dhe asaj botërore në kontekstin historik, shoqëror dhe kulturor ku ajo u zhvillua. Nxënësit, përmes njohjes së zhvillimit të muzikës në periudha të ndryshme dhe përfaqësuesve të saj, zhvillojnë një mënyrë komunikimi, duke përdorur një gjuhë të thjeshtë muzikore. Përjetimi i gjendjeve të shumta emocionale muzikore i ndihmon nxënësit të zhvillojnë përgjigjet e tyre emocionale për muzikës shqiptare apo atë botërore që ata dëgjojnë, qoftë kjo tradicionale, klasike apo moderne. Debati, analiza dhe vlerësimi i disa prej veprave më të spikatura muzikore do të shoqërojë nxënësit gjatë studimit të njohurive dhe punës së tyre, duke zhvilluar qëndrimet dhe vlerësimet ndaj pjesëve muzikore që dëgjojnë, pavarësisht llojit apo gjinisë muzikore.

**Orët e sugjeruara: 16**

Linja	Objektivat
<p style="text-align: center;"><b>Historia e muzikës</b></p>	<p>Në përfundim të këtij programi nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• të përshkruajë zhvillimin e muzikës shqiptare dhe asaj botërore gjatë periudhave të ndryshme historike, duke u mbështetur në veprat muzikore dhe kompozitorët më të spikatur*.</li> </ul> <p style="padding-left: 40px;">Periudhat e marra në studim:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>○ muzika në periudhën e lashtësisë,</li> <li>○ muzika në periudhën e mesjetës,</li> <li>○ muzika në periudhën barok,</li> <li>○ muzika në periudhën e klasicizmit,</li> <li>○ muzika në periudhën e romantizmit,</li> <li>○ muzika në shek. XX;</li> <li>○ muzika shqiptare në periudhën e <i>Mesjetës</i>,</li> <li>○ muzika shqiptare në periudhën e Rilindjes</li> <li>○ muzika shqiptare pas viteve 45' të shek. XX.</li> </ul> <ul style="list-style-type: none"> <li>• të krahasojë dy pjesë muzikore shqiptare apo të huaja që parapëlqen (p.sh.: një pjesë vokale apo instrumentale), duke folur për karakteristikat muzikore të tyre;</li> <li>• të diskutojë rreth subjektit të një opere duke u nisur nga vepra dhe autori, rreth muzikës së saj, duke u nisur nga karakteristikat e muzikës dhe rreth periudhës së cilës i përket kjo opera;</li> <li>• të debatojë mbi një vepër muzikore, duke e zhvilluar debatin mbi llojin muzikor (muzika instrumentale, muzika vokale, muzika skenike) mbi llojin e interpretimit të veprës muzikore; (orkestër harqesh, orkestër simfonike) dhe mbi përmbajtjen e veprës;</li> <li>• të marrë pjesë në shfaqje artistike muzikore të qytetit apo rajonit ku jeton, në veprimtari të ndryshme artistike në</li> </ul>

---

\* Autorët dhe veprat duhet të jenë më të spikaturit e periudhës.

### Linja 3: Historia e kërcimit shqiptar

**Përshkrimi i linjës:** Historia e kërcimit njih nxënësit me etapat e zhvillimit të kërcimit shqiptar dhe të huaj nga lindja deri në ditët tona, duke renditur karakteristikat e ndryshme të zhvillimit të kërcimit. Përmes studimit të kërcimit, lindjes së baletit dhe formave të tjera të kërcimit, si dhe veprave më të arrira e përfaqësuesve kryesore, nxënësit kuptojnë më mirë zhvillimin e këtij arti në kontekstin historik, shoqëror dhe kulturor të vendit ku ato kanë lindur dhe janë zhvilluar.

Njohja me baletit romantik, përfaqësuesit e baletit Rus gjatë shekullit XIX - XX, si dhe baletet e para simfonike, zhvillimi i kërcimit modern që i përket shek. XX, kërcimet dhe rrymat më kryesore të zhvillimit të kërcimit modern, janë pjesë e studimit të kësaj disipline duke përcaktuar vlerat artistike përmes autorëve kryesorë që i krijuan si dhe kërcimtarëve që u dhanë jetë. Gjithashtu historia e kërcimit plotëson nxënësit me njohuri të përgjithshme të zhvillimit të kërcimit shqiptar, me veprat kryesore e më të spikatura të kërcimit shqiptar, si dhe me përfaqësuesit kryesorë të këtyre veprave.

**Orët e sugjeruara: 13**

Linja	Objektivat
<b>Historia e kërcimit</b>	<p>Në përfundim të këtij programi nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• të përshkruajë zhvillimin e artit të kërcimit, duke njohur periudhat dhe veprat artistike më të rëndësishme, zhanret dhe disa nga përfaqësuesit më të spikatur* shqiptarë dhe të huaj.</li> </ul> <p style="text-align: center;">Periudhat e marra në studim:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>○ arti parahistorik dhe kërcimi,</li> <li>○ kërcimi gjatë mesjetës,</li> <li>○ kërcimi gjatë Rilindjes dhe lindja e baletit si gjini,</li> <li>○ zhvillimi i baletit në Itali dhe Francë, reformat e Noverit,</li> <li>○ baleti romantik në shekullin e XIX,</li> <li>○ baleti Rus në shek. XIX – XX dhe baletet e para simfonike,</li> <li>○ kërcimi në shek. XX- zhvillimi i mëtejshëm i baletit klasik dhe reformat e para moderne,</li> </ul>

\* Autorët dhe veprat duhet të jenë më të spikaturit e periudhës.

	<ul style="list-style-type: none"> <li>○ lindja e kërcimit modern dhe përfaqësuesit kryesorë të tij,</li> <li>○ vallja dhe karakteristikat kryesore sipas trevave në Shqipëri e më gjerë,</li> <li>○ zhvillimi i baletit në Shqipëri në shek. XX,</li> <li>○ veprat më të rëndësishme dhe përfaqësuesit e koreografisë shqiptare.</li> </ul> <ul style="list-style-type: none"> <li>● të shpjegojë lidhjen midis llojeve të artit: <i>muzika, skenografia dhe letërsia</i>;</li> <li>● të dallojë karakteristikat e baletit modern dhe atij klasik, duke u ndalur në disa komponentë, si: <i>muzika, lëvizjet dhe kostumet</i>;</li> <li>● të përshkruajë zhvillimet e kërcimit shqiptar që nga fillimet e saj, duke nxjerrë në pah karakteristikat historike, artistike dhe estetike të kërcimeve të ndryshme; <ul style="list-style-type: none"> <li>● të diskutojë rreth zhvillimit të kërcimit dhe krijimit të veprave koreografike me përfaqësues kryesorë shqiptarë dhe të huaj;</li> <li>● të marrë pjesë si pjesëmarrës/e ose organizator/e në veprimtari të ndryshme artistike në klasë, shkollë, mjedisin ku jeton, në komunitet dhe shoqëri.</li> </ul> </li> </ul>
--	--

#### **Linja 4: Historia e teatrit**

**Përshkrimi i linjës:** Historia e teatrit njih nxënësit me etapat kryesore të zhvillimit të teatrit shqiptar dhe atij botëror nga periudha antikitetit deri në ditët tona, duke përcaktuar ndikimet dhe karakteristikat e tij historike, shoqërore dhe artistike në shoqërinë njerëzore në këto periudha. Përmes njohjes së zhvillimit historik të teatrit, nxënësit do të studiojnë zhvillimin e elementeve kryesore që përbëjnë teatrin, *zhvillimin e dramës, të skenës, të artit të aktorit* etj. Nëpërmjet analizave historike dhe artistike të disa prej veprave më të shquara dhe më përfaqësuese të dramaturgjisë shqiptare apo asaj të huaj nxënësit do të kryejnë diskutime, debate apo detyra konkrete.

**Orët e sugjeruara: 18**



Linja	Objektivat
<p><b>Historia e teatrit</b></p>	<p>Në përfundim të këtij programi nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• të përshkruajë <i>etapat kryesore</i> të zhvillimit historik të teatrit duke njohur periudhat, veprat më të rëndësishme skenike dhe disa nga përfaqësuesit më të spikatur* shqiptarë dhe të huaj.</li> </ul> <p>Periudhat e marra në studim:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>○ lindja e teatrit dhe origjina e tij,</li> <li>○ lindja e tragjedisë dhe përfaqësuesit e teatrit antik greko-romak nga shekulli i 5<sup>të</sup> p.e.r e deri në shekullin e 5<sup>të</sup> të e. re,</li> <li>○ teatri gjatë mesjetës nga shekulli i 5<sup>të</sup> deri në shekullin e 15<sup>të</sup>,</li> <li>○ teatri gjatë Rilindjes në Evropë,</li> <li>○ teatri i klasicizmit,</li> <li>○ teatri iluminist dhe romantik,</li> <li>○ drama romantike franceze, dramaturgjia angleze, teatri italian, teatri gjerman, teatri rus, etj.,</li> <li>○ teatri realist dhe ai modern i shek. XIX-XX,</li> <li>○ teatri ekzistencialist dhe teatri i absurdit i shek. XX,</li> <li>○ teatri shqiptar në antikitet,</li> <li>○ teatri folklorik,</li> <li>○ teatri në periudhën e Rilindjes Kombëtare,</li> <li>○ teatri në periudhat 1912- 1945 dhe pas vitit 1945,</li> <li>○ teatri dhe kinemaja pas vitit 1945 deri në ditët tona.</li> </ul> <ul style="list-style-type: none"> <li>• të përshkruajë zhvillimet e artit dramatik shqiptar dhe të huaj, mbështetur në karakteristikat <i>specifike, historike dhe artistike</i> të veprave të veçanta;</li> </ul>

---

\* Autorët dhe veprat duhet të jenë më të spikaturit e periudhës.

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• të përdorë diskutimet dhe debatin rreth zhvillimit të kulturës skenike, si dhe veprave e përfaqësuesve kryesorë shqiptarë;</li> <li>• të përshkruajë zhvillimet e teatrit, përmes karakteristikave të tyre historike, shoqërore dhe artistike;</li> <li>• të analizojë një nga veprat më përfaqësuese të dramaturgjisë botërore, duke u mbështetur në elementet përbërës të saj si: <i>lloji i skenës, arti i aktorit dhe regjisorit</i> etj;</li> <li>• të analizojë <i>cilësinë</i> e realizimit të veprave të ndryshme skenike apo kinematografike, duke përdorur një fjalor të përshtatshëm artistik;</li> <li>• të marrë pjesë në veprimtari të ndryshme artistike në klasë, shkollë etj.</li> </ul>
--	--

<b>ART PAMOR</b>	<b>HISTORI</b>
Zhvillimi i historisë njerëzore në lidhje me artin pamor.	Nxënës/i, -ja: <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ të përshkruajë ngjarjet historike, sociale, politike dhe kulturore që kanë lënë gjurmë në secilën periudhë historike;</li> <li>▪ të përshkruajë kthesat e mëdha historike që kanë ndikuar fort në zhvillimin e shoqërisë njerëzore të këtyre periudhave.</li> </ul>
<b>KËRCIMI</b>	<b>HISTORI</b>
Kërcimi në periudhën e shek. 17, 18, 19, 20 -të	Nxënës/i, -ja: <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ të përshkruajë ngjarjet historike, sociale dhe kulturore që kanë lënë gjurmë në këto periudha.</li> </ul>
<b>DRAMA</b>	<b>GJUHA SHQIPE</b>
<i>Fjala</i> dhe roli i saj si mjet kryesor në interpretimin e aktorit.  <i>Të folurit skenik:</i> veprimi nëpërmjet fjalës, përshtatja, komunikimi i ndjenjave nëpërmjet fjalës, emocioneve, ideve, qëllimeve të shfaqura dhe të pashfaqura të njeriut në jetë dhe aktorit në skenë, nënteksti etj.	Nxënës/i, -ja: <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ të njohë dhe të praktikojë shqiptimin e saktë të zanoreve dhe bashkëtingëlloreve.</li> <li>▪ të njohë dhe të praktikojë diksionin e fjalës, shqiptimin e saktë të saj.</li> <li>▪ të përdorë elementet e teknikës së theksit logjik dhe emocional, si dhe rolin e intonacionit në komunikim.</li> <li>▪ të njohë dhe të praktikojë për të zotëruar stile të ndryshme të së folurës.</li> <li>▪ të identifikojë forcën që mbart fjala për të individualizuar njeriun në jetë dhe personazhin në skenë.</li> </ul>
<b>DRAMA</b>	<b>LETËRSIA</b>
<i>Analiza</i> e një vepre dramatike me të gjithë elementët strukturorë të saj.  <i>Zhvillimi historik</i> i dramaturgjisë nëpër etapa të ndryshme: Antikiteti, Rilindja, Klasicismi, Romantizmi, Iluminizmi, Realizmi, Drama bashkëkohore etj.  <i>Drama</i> si gjini letrare krahasuar me gjini të tjera letrare, proza, poezia etj.  <i>Studimi i mjeteve të shprehjes artistike:</i> metafora, simboli etj.	Nxënës/i, -ja: <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ të bëjë analizën e një vepre letrare që në thelb është e njëjtë me analizën e një vepre dramatike. Zbulojë temën, idenë, stilin, konfliktin; analizon personazhet, përshkruan strukturën kompozicionale, etj.</li> <li>▪ të njohë etapat e ndryshme të zhvillimit të artit dhe letërsisë, duke përshkruar karakteristikat kryesore të tyre.</li> <li>▪ të bëjë krahasimin e gjinive të ndryshme letrare, duke identifikuar specifikat e tyre sidomos specifikat e dramës si gjini letrare e destinuar për në skenë.</li> <li>▪ të njohë larinë e figurave artistike letrare dhe t'i përshtasë ato në gjininë dramatike si dhe me tendencat e ndryshme letrare dhe filozofike që kanë pasur pasqyrimin e tyre edhe në dramaturgji dhe në teatër.</li> </ul>
<b>MUZIKA</b>	<b>HISTORI</b>

## 5. KËRKESA PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Ky program është një dokument zyrtar, pjesë e tërësisë së dokumenteve zyrtare për lëndën e historisë së arteve. Dokumentet e tjera kryesore janë korniza kurrikulare e gjimnazit dhe standardet e fushës kurrikulare të arteve, ku kjo lëndë bën pjesë. Hartimi i programit është mbështetur si te korniza kurrikulare, ashtu edhe te standardet e fushës.

Historia e arteve në shkollat e Arsimit Profesional studiohet në klasën e 13-të, në 66 orë mësimore gjithsej, me 2 orë në javë. Programi i Historisë së arteve do të thellojë dhe zgjerojë përvojat e fituara nga nxënësit në arsimin e detyruar. Programi i historisë së arteve organizohet sipas linjave, ku çdo linjë do të përfaqësojë një disiplinë përkatësisht: *artin pamor, kërcimin, muzikën, teatrin dhe kinemanë.*

Përmes këtij programi nxënësit njohin, studiojnë dhe vlerësojnë periudhat në të cilat u zhvillua arti në botë dhe Shqipëri, veprat dhe përfaqësuesit më të spikatur të çdo periudhe. Ata përshkruajnë, krahasojnë dhe mbajnë qëndrim kritik, duke vlerësuar opinionet e gjithsecilit për çdo vepër arti të marrë në analizë.

Për zhvillimin e kësaj lënde, mësues/i,-ja punon vetëm dhe në grup, zhvillon biseda, konkurse, veprimtari artistike etj.

*Të menduarit kritik për zhvillimin e qëndrimeve dhe vlerësimin e një vepre artistike.*

Për të formuar njohuritë dhe qëndrimet artistike të nxënësve në lëndën e historisë së arteve, në përshtatje me natyrën që kanë artet në përgjithësi, mësues/i,-ja duhet të zhvillojë tek nxënësit kulturën e nevojshme artistike, të domosdoshme për njohjen, evidentimin dhe studimin e veprave të autorëve më përfaqësues, duke evidentuar karakteristikat e veprave më kryesore që ata kanë krijuar. Programi i historisë së arteve kërkon nga zbatuesit që kjo lëndë të mos zhvillohet vetëm në planin teorik, por të trajtohet edhe si një lëndë që përmes *detyrave individuale* apo *punëve në grup*, të zhvillojë aftësitë *analizuese*, dhe *vlerësuese* të veprave të artit qofshin figurative, skenike, vokale etj., ku çdo nxënës/e duhet të përftojë aftësitë për të mbajtur qëndrim artistik dhe kritik ndaj tyre.

Zbatimi i programit duhet të bëhet duke respektuar parimet e barazisë gjinore, etnike, kulturore, racore dhe fetare.

### **Objektivat e programit**

Objektivat e programit janë për të gjithë nxënësit. Kjo do të thotë se të gjithë nxënësve duhet t'u jepet mundësia për të nxënë çka përshkruhet tek objektivat. Realizimi i objektivave në tema apo njësi mësimore, si dhe renditja e tyre është zgjedhje e lirë e zbatuesit të programit. P.sh.: objektivi i marrë nga linja e artit pamor: “ të përcaktojë për çdo periudhë *autorët* më të spikatur dhe *veprat më të njohura të tyre*”, kërkon që të gjithë nxënësit të njohin zhvillimet e artit jo duke riprodhuar në mënyrë mekanike njohuritë e marra, por duke gjetur dhe evidentuar përveç autorit disa prej karakteristikave të veprave më të spikatura që bënë epokë, p.sh.: *vendin ku u krijua vepra, lloji i veprës, përmbajtja e saj etj...*\*. Nëse një përdorues i programit nuk e bën këtë, nuk ka zbatuar programin lëndor.

Mësues/i,-ja dhe autorët e materialeve mësimore duhet të mbulojnë të gjithë gamën e niveleve të nxënësve.

Veprat e sugjeruara që duhet të trajtojnë përdoruesit e këtij programi duhet të jenë veprat më të njohura të autorëve. Punët apo veprimtaritë që u kërkohen nxënësve, mund të jenë një ese, një projekt ose veprimtari tjetër krijuese, të zhvilluara individualisht apo në grup.

### **Orët mësimore**

Programi i historisë së arteve është strukturuar në 4 linja që vijnë njëra pas tjetrës.

Sasia e orëve mësimore për secilën linjë është rekomanduese. Përdoruesit e programit duhet të respektojnë sasinë e orëve vjetore të lëndës, por janë të lirë të ndryshojnë me 10% (shtesë ose pakësim) orët e rekomanduara për secilën linjë.

Domethënë, mësues/i,-ja mund të vendosë të vazhdojë më ngadalë kur vë re se nxënësit hasin vështirësi të veçanta në përmbushjen e objektivave mësimore, por mund të ecë më shpejt kur nxënësit demonstronjë një përvetësim të kënaqshëm.

Në programin e lëndës së historisë së arteve afërsisht **70%** e totalit të orëve mësimore janë për shtjellimin e njohurive të reja lëndore, ndërsa **30%** e tyre janë për përpunimin e njohurive (gjatë vitit dhe në fund të vitit shkollor).

### **Përpunimi i njohurive**

Përpunimi i njohurive përmban:

- përsëritjen brenda një linje të caktuar të njohurive bazë të tij (njohuritë dhe konceptet themelore);
- testimin e njohurive bazë;

---

\* Ky shënim është i vlefshëm për të gjithë përdoruesit e programit.

- integrimin e njohurive të reja të një linje me njohuritë paraardhëse;
- integrimin e njohurive të reja me njohuritë e lëndëve të tjera brenda fushës së arteve apo edhe më tej (ndonëse këto integrimi do të përshkojnë zhvillimin e çdo ore mësimore, gjatë përpunimit i duhet kushtuar kohë e posaçme);
- projektin kurrikular lëndor që mund të jetë lëndor apo ndërlëndor;
- përsëritjen vjetore (pavarësisht nga ndarja në linja, lënda duhet parë si një e tërë);
- shkrimin e një eseje rreth 800 fjalë, duke përcjellë emocionet dhe qëndrimin personal rreth një shfaqjeje/vepre artistike, ku pika mbështetëse për hartimin e saj mund të jenë: autori, përmbajtja e veprës, skena, kostumet, interpretuesit etj.;
- projektin p.sh.: me temë “*Shekulli i XIX, shekulli i baletit, i operës dhe i muzikës simfonike*”.

Në orët mësimore që i përkasin përpunimit të njohurive, mësues/i,-ja zhvillon edhe tema me nismën e tij/saj ose me kërkesën e vetë nxënësve. Këto tema mund ta kenë pikën e nisjes nga temë mësimore aktuale ose thjesht nga kureshtja e nxënësve.

Veçanërisht gjatë përpunimit të njohurive duhet t’i kushtohet kohë e posaçme kultivimit të:

*1. aftësive të posaçme lëndore:*

- o *komunikuese*; komunikimin e saktë të njohurive, mendimeve dhe qëndrimeve rreth arteve në përgjithësi dhe veprave të ndryshme, duke përdorur një fjalor të thjeshtë artistik;
- o *analizuese*; analizimin e një vepre arti shqiptare apo botërore, duke nxjerrë në pah karakteristikat e saj p.sh.: *në muzikë*: duke dëgjuar një nga veprat më të njohura të Bethovenit (*simfonia e nëntë, apo sonata e hënës*) ata do të kuptojnë gjuhën e muzikës në përgjithësi, duke depërtuar sa më mirë në mendimin që shpreh vepra;
- o *krahasuese*; krahasimin e dy veprave artistike, qofshin këto muzikore, figurative, skenike apo koreografike;
- o *krijuese*; shkrimin e një eseje (rreth 800 fjalë), duke nxjerrë karakteristikat e një vepre artistike, për të sjellë opinionin dhe qëndrimin personal;

*2. formimit të qëndrimeve*, si qëndrimi etiko-social etj., dhe qëndrimi gjatë punës në grupe të vogla nxënësish.

Gjatë orëve të përpunimit të njohurive, nxënësve duhet t’u krijohet mundësia të

punojnë detyra tematike, bazuar mbi një tematikë të caktuar etj.

Me nxënësit me vështirësi në të nxënë, duhet të punohet veçmas për realizimin e detyrave, duke iu përshtatur stileve të tyre të të nxënit.

Për zhvillimin e kësaj lënde, rol të rëndësishëm luan *mjedisi, metodat* dhe përdorimi i *teknologjive mësimore* (TV, video, magnetofon, CD, DVD, projektorë etj.), ndërsa për realizimin e projekteve, në varësi nga tema e tyre, kërkohet bashkëpunimi dhe puna në grup.

## 6. VLERËSIMI

Vlerësimi i nxënës/it,-es përshkon gjithë procesin mësimor dhe shërben për përmirësimin e këtij procesi. Vlerësimi i nxënës/it,-es nuk ka për qëllim të vetëm vendosjen e notës dhe as nuk përfundon me vendosjen e saj.

Vlerësimi mbështetet tërësisht në objektivat, programin lëndor dhe mësues/i,-ja nuk ka të drejtë të vlerësojë nxënësit për ato objektiva të arritjes që nuk përshkruhen në program.

Objektiv i vlerësimit nuk janë vetëm njohuritë, por edhe qëndrimet e nxënësve, si qëndrimet etiko-sociale dhe ato të bashkëpunimit me të tjerët.

Mësues/i,-ja zhvillon vetë dhe në bashkëpunim me nxënësit, një larmi mënyrash vlerësimi, që kanë të bëjnë me:

- përdorimin e saktë të *njohurive mbi 4 fushat e arteve*;
- dallimin e individit (nxënës/it,-es) më të suksesshëm gjatë debatit për krahasimin e dy veprave të artit botëror (art pamor, muzikë, teatër apo kërcim);
- shkrimin e esesë (rreth 800 fjalë) duke përcjellë saktë qëndrimin e vet rreth një shfaqjeje/vepre artistike si dhe duke përcjellë emocionet e veta rreth skenës, veshjeve, muzikës, interpretuesve etj.;
- vlerësimin përfundimtar të një punimi kursi për krijimin e një posterit: ku të veçojnë piktorin/aktorin/kompozitorin/regjisorin apo balerinin e preferuar shqiptar apo të huaj; CD: ku të sjellë muzikën e preferuar; album me vepra arti 2 – 3 dimensionale etj.;
- evidentimi i individit (nxënës/it,-es), për kërkimin dhe prurjen e informacioneve të sakta dhe në koherencë me detyrën e kërkuar.

Vlerësimi mund të bëhet individual ose në grup, në klasë ose jashtë saj.

Mësues/i,-ja nuk e ka të detyrueshëm vlerësimin me notë të nxënësve në çdo orë mësimore, por për punë të paracaktuara të nxënësve me grupe të vogla, mësues/i,-ja

parashtron peshën e vlerësimit me notë të grupit në tërësi apo edhe të çdo nxënësi/e në veçanti.

Si rregull, nxënësit dhe mësues/i,-ja duhet të bashkëbisedojnë lirshëm si partnerë rreth përvetësimit të njohurive të fituara të orëve të kaluara dhe mirëkryerjes së detyrave jashtë klase.

Herë pas here mësues/i,-ja duhet të vlerësojë me notë, duke ua bërë të qartë nxënësve që në fillim qëllimin e vlerësimit dhe kriteret e tij.

Portofoli i nxënës/it,-es, është një mundësi vlerësimi e vetëvlerësimi, si dhe një koleksion i punimeve të nxënësve përgjatë vitit shkollor. Ai/ajo mund të përmbajë detyra të ndryshme tematike, të gjitha në dobi të veprimtarive të ndryshme shkollore, produkte të veprimtarive kurrikulare etj. Ato mund të jenë:

- 1 ese,
- albume me foto të artistëve të ndryshëm apo nga vepra e luajtura në skenë,
- Cd apo DVD nga vepra të ndryshme artistike, vokale, koreografike, teatrale apo figurative shqiptare apo të huaja,
- etj.

Përzgjedhjet për portofolin bëhen nga nxënësit, mësues/i,-ja rekomandon.